



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË
PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU - BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.1/24

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Kryetarja e gjykatës Shpresa Emra, duke vepruar sipas kërkesës për inicim të procedurës disiplinore të parashtruar nga ana e ankuesit S.B., nga fshati Semetishte Komuna e Suharekës, ndaj gjyqtares N. B., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtares sipas lëndës civile C.m. 1629/20, në bazë të së cilës është bërë inicimi i procedurës disiplinore, me dt.21.02.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e ankuesit S.B., nga fshati S. Komuna e Suharekës, ndaj gjyqtares N. B., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e Gjyqtares sipas lëndës civile C.nr.1629/20.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës ankuesit S.B., nga fshati S Komuna e Suharekës, ka parashtruar Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares N. B., Gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil, lidhur me veprimet dhe sjelljen e gjyqtares sipas lëndës civile C.nr. 1629/20.

Ankuesi S.B., ankesën e ka parashtruar nëpërmjet Ndihmës Juridike Falas ku ka cekur se Gjykata Themelore në Prizren, respektivisht gjyqtarja N. B., ka nxjerr Aktvendim me dt.29.09.2021 me të cilën kjo gjykatë është shpallur jo kompetent në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Themelore në Prizren Dega në Suharekë. Ky aktvendim është shpallë nëpërmjet afishimit në tabelën e shpalljeve publike pasi që gjyqtarja ka konstatuar se në bazë të flete kthesës paditësi ka vdekur dhe familja është shpërngulur nga kjo adresë. Ankuesi ka cekur se kjo nuk është e vërtetë dhe me qëllim të sqarimit të çështjes ka tentuar të kontaktojë me gjyqtaren e cila nuk ka pranuar të bisedojë , ka kontaktuar me Zyrën e Avokatit të Popullit në Prizren dhe pas intervenim te tyre ka pranuar te njejtin Aktvendim . IME pas ka kërkuar cië të kete qasje në dokumentacionin e lëndës dhe në fletëkthesën ne mënyrë që të verifikon konstatimin e postës për informatën e vdekjes së tij. MË pas i ka dërguar gjyqtares Certifikatën e lindjes si dhe

certifikaten e vendbanimit për të dëshmuar se është gjallë dhe se nuk ka ndryshuar vendbanimin . Gjyqtarja nuk i është përgjigjur dhe nuk e ka pranuar dhe ai ka përjetuar stres dhe traumë dhe në situatë të këtyllë ka parashtruar këtë ankesë për shkak të shkeljes disiplinore sipas pikës 2.1 dhe 2.2 të Nenit 5 të Ligjit nr. 061-057 për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokuroreve dhe shkelje disiplinore sipas Ligjit nr.06/L-081 për qasje në Dokumente Publike.

Gjyqtarja në deklaratën e saj lidhur me pretendimet e ankuesit ka cekur se lëndën C.nr.1629/20 e ka pranuar me dt. 16.05.2022 me vendim të Kryetares së gjykatës, pasi që gjyqtari gjykues i cili ka qenë i ngarkuar me këtë lëndë tani nuk është në gjykatë. Gjyqtari paraprak në këtë lëndë ka vendosur me Aktvendim Cm. 1629/2020 me dt. 29.09.2021 ku Gjykata Themelore në Prizren është shpallur jo kompetent në pikëpamje territoriale për të vendosur në kete çështje kontestimore dine pas plotfuqishmërisë lënda është dërguar në Gjykatën Themelore ne Prizren dega në Suharekë. Me rastin e dergimit të këtij aktvendimi tek pala, dërgimi nuk ka mundur të behet pasi që nga shërbimi postar është konstatuar "se pala ka vdekur dhe familjarët janë shpërngulur". Lënda është bartur në Suharekë, por pas një kohe është kthyer për shkak se nuk është bërë bartja në rregull cihe se nuk është ekspeduar në mënyrë të rregullt. Me vendim të kryetares gjyqtarja ka pranuar lëndën cihe duke pasur parasysh se është dashur që të veprohet vetëm sa i perket dorëzimit të aktvendimit palës, e nejtja ka vepruar sipas ligjit bazuar në konstatimin e vdekjes se palës, aktvendimin e ka shpallur në tabelë të shpalljes dhe më pas kur është bërë i plotëfuqishëm lënda është dërguar në Gjykatën Themelore në Suharekë si gjykatë kompetente. Gjyqtarja vetëm ka vazhduar me veprimet procedurale sa i përket kësaj Ende pasi cië Aktvendimi është marre nga ana e gjyqtarit i cili nuk është ne gjykatë . Lënda është pranuar nga ana e Gjykatës Themelore në Prizren Dega në Suhareke ku është vendosur sipas padisë së paditësit S.B., kundër të paditurve Komuna e Suharekës, B.M., dhe E.Sh., Aktualisht lënda është ne Gjykatën e Apelit sipas ankesës.

Sa i përket faktit se gjyqtarja nuk ka pranuar palën ankuese S.B., dhe nuk i ka dorëzuar flete kthesën e postës është e vërtetë se nuk e ka pranuar palën në bisedë sepse kjo është në kundërshtim me kodin e etikës për gjyqtarë kurse sa i perket shkresave të lëndë pala është informuar se lenda është ne Gjykatën Themelore në Suharekë si gjykatë kompetente cihe se ka mundur të parashtrrojë kërkesë Zyrës së menaxhimit të lëndëve në Suharekë dhe të sigurojë qasje në dokumente pasi që kjo zyre është kompetentë për dorëzim të dokumenteve publike , në kuptim të nenit 1.13 të Ligjit për qasje në dokumente publike dhe sipas nenit 27 par.2 të Rregullores së Brendshme të Gjykatës .Gjyqtarja ka cekur se kjo kërkesë është e paarsyeshme dine se në veprimet e saja gjatë procedurës ne këtë çështje kontestimore nuk ka shkelje te detyrave të gjyqtarit ose shkelje disiplinore nga ana e saj.

Autoriteti kompetent - Kryetarja e gjykatës pasi që ka pranuar Ankesë ndaj gjyqtares N. B., gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prizren, Departamentin e Përgjithshëm Divizioni Civil, lidhur me lëndën C.nr. 1629/20 ka iniciuar hetimet preliminare për procedurë disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shikimin në ankesën e parashtruar, ka kërkuar deklarate nga gjyqtari i çështjes ka bërë verifikimin e shkresave te lëndës C.nr. 1629/20. Pas vlerësimit dhe analizës së tërësishme të provave te mbledhura Autoriteti Kompetent konsideron se:

Ankesa është e pabazuar.

Autoriteti kompetent - Kryetarja pas verifikimit të gjithë dokumentacionit ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon:

Në Gjykatën Themelore ne Prizren është dorëzuar padia për shkak të kompensimit të dëmit me dl. 12.11.2020 nga ana e paditësit S.B., nga fshati Semetisht , Komuna e Suharekës , kunder të paditurve Komuna e Suharekes, B.M., nga Suhareka cihe E.Sh., nga Suhareka. Lënda fillimisht i është ndarë gjyqtarit F.V., i cili duke shqyrtuar kompetencën e gjykatës, me aktvendim C.nr. 1629/20 me dt. 29.09.2021 është shpallur inkompetent në pikëpamje territoriale dhe është urdhëruar që pas plotfuqishmërisë lënda të dërgohet në Gjykatën Themelore në Prizren, Dega e Suharekë. Me rastin e dërgimit Aktvendimit palës, nga ana e shërbimi postar është konstatuar "se pala ka vdekur dhe familjarët janë shpërngulur". Lënda është bartur në Suhareke, por pas një kohe është kthyer për shkak se nuk është bërë bartja në rregull dhe nuk është ekspeduar ne menyre të rregullt. Në nderkohë gjyqtari F.V., nuk ka punuar në këtë gjykatë dhe me vendim të kryetares gjyqtarja N. B., ka pranuar lëndën. Duke pasur parasysh se është dashur që të veprohet vetem sa i përket dorezimit të aktvendimit palës, e njëjta ka vepruar sipas ligjit bazuar në konstatimin e vdekjes së palës, aktvendimin e ka shpallur në tabelâ te shpalljes cihe më pas kur është bërë i plotëfuqishëm lënda është dërguar në Gjykatën Themelore në Suharekë si gjykatë kompetente. Lënda është pranuar nga ana e Gjykates Themelore në Prizren Dega në Suharekë ku është vendosur sipas padise së paditesit S.B., kundër të paditurve Komuna e Suharekës, B.M., dhe E.Sh., Aktualisht lënda me të gjitha shkresa të lëndës është në Gjykatën e Apelit sipas ankesës.

Bazuar në lartëcekura dhe me shiqim ne shkresa të lëndës është vërtetuar se në shkresa të lëndës qendron konstatimi për vdekjen e palës nga ana e shërbimit postar në bazë të së cilës ka vepruar gjyqtarja N. B., e cila sipas ligjit ka bërë shpalljen e Aktvendimit ne tabelê te shpalljes dhe më pas lëndën, pas plotfuqishmërisë e ka dërguar në kompetencë në Gjykatën Themelore në Suharekë. Në Gjykatën Themelore në Prizren , Dega në Suharekë lënda i është ndarë gjyqtarit S.G., i cili e ka ftuar palën në mënyrë te rregullt , ka mbajtur seancën dhe ka vendosur në mënyrë meritore me Aktgjykim me dt. 22.11.2022. Momentalisht lenda sipas ankesës gjendet ne Gjykatën e Apelit. Në veprimet e gjyqtares N. B., nuk ka elemente të shkeljes disiplinore dhe shkeljes së detyrës së punës së gjyqtarit pasi e njëjta ka vepruar sipas ligjit dhe me atë veprim nuk ka cenuar të drejtën e palës në vendosje , sepse nuk ka vendosur në mënyrë meritore, por ka kryer një veprim procedural në rrjedhën e zhvillimit të lëndës. Sa i përket pranimi të palës në bisedë nga ana e gjyqtares sipas Kodit te etikës për gjyqtarë , gjyqtarja nuk mund te realizon bisede ex-parte me njëren palë ne kontest , gjë cië gjyqtarja e ka respektuar cihe nuk ka pranuar bisedën me palë. Lidhur me kerkesën për informata të cilat i ka kërkuar pala ankuese te njëjtat i janë dhenë me Njoftim me dl. 15.12.2021 tek Avokati i Popullit ku i njëjti është ankuar dhe ka kërkuar informacione.

Në lidhje me konstatimin nga ana e shërbimit postar për vdekjen e palës, që është informacionjo i vërtetë Kryetarja e Gjykatës do të kërkojë sqarim nga ana e Zyrës mbikëqyrëse të Shërbimit Postar dhe pas pranimi të informatës do të veprojë sipas ligjit.

Andaj si Autoritet Kompetent bazuar në të lartëcekura konsideron se gjyqtarja N. B., në veprimet e saja nuk ka pasur shkelje të cilat konsistojnë me shkeljet disiplinore të parapara me nenin 5 par. 1 nënpar.1.3 dhe nenin 5 par.2 nënpar.2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ku është paraparë trajtimi me ligj i palëve në procedurë giatë ushtrimit të detyrës së saj zyrtare si gjyqtare.

Për arsyet që u cekura më lartë, Autoriteti Kompetent — Kryetarja e Gjykatës ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.1/2024, me dt.21.02.2024



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e parapare e drejta e ankesës.